



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 dhe nenit 76 paragrafi 2 alinea 2 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr 12/2019) dhe nenit 40 nga Rregullorja për punë të Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), duke vepruar me iniciativë të veten të seancës së 41-të, të mbajtur me datë 11.11.2020 morri

VENDIM

Procedura e formuar për lëndën pas informacioneve të marrura të publikuara nga mediumet në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lidhje me mënyrën e punësimit të personit Sanja Dimitriovska në Agjensionin për komunikime elektronike (AKE), e cila paraprakisht ka kryer funksionin e sekretarit shtetëror në MPB, **NDËRPRITET**.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka bazë për procedurë kompetente të mëtutjeshme në lëndën me numër 09-1105/1 nga data 07.03.2019.

Lënda me numër 09-1105/1 nga data 07.03.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Sqarim

Lënda me numër 09-1105/1 nga data 07.03.2019 e formuar sipas detyrës zyrtare mbi bazë të informacioneve të fituara nga mediumet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në bazë të kontrollimit të mënyrës së punësimit të personit Sanja Dimitriovska në AKE, e cila paraprakisht ka kryer funksionin e Sekretarit shtetëror në MPB.

Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit me qëllim që të përcakton gjendjen faktike dhe të vërteton akuzat nga mediumet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, deri te AKE dërgonë kërkesë për sigurimin e dokumentacionit në lidhje me procedurën e dokumentacionit e cila ka të bëjë me punësimin e personit Sana Dimitriovska, me çka KSHPK e vërtetoi gjendjen vijuese:

Me datë 25.05.2017 Komisioni i Agjensionit për komunikime elektronike e mbajti takimin e shtatë, në të cilin njëra nga pikat e rendit të ditës ishte edhe Propozim rregullorja për ndryshime të rregullores për sistematizim të vendeve të punës të AKE. Me ndryshimin e theksuar të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në AKE me numër 0101-1624/1 nga data 23.05.2017, në pjesën e përshkrimit të vendit të punës në pikën 1 nënpika 1.7 Këshilltarë i drejtorit për resurse njerzore dhe bashkëpunim ndërkombëtar, në tabelën, në rendin Lloji i arsimimit fjala "shkenca ekonomike" zëvendësohet me fjalën "makineri".

Me datë 25.05.2017 nga ana e AKE është dorëzuar Kërkesë-mendim deri tek KSHPK me numër 0201-1653/1 që ka të bëjë, se vallë a mund të transferohet një person në AKE gjatë periudhës zgjedhore, me çka KSHPK me datë 29.05.2017 dha Mendim me numër 12-4057/2 se nuk ekziston pengesë ligjore që AKE ta

realizon procedurën për transfer të një personi nga institucion tjetër publik, përshkak të punëve urgjente dhe punëve që nuk shtyhen për më vonë.

Komisioni i Agjensionit për komunikime elektronike pas mbarimit të mbledhjes së tetë me datë 30.05.2017 në të cilën u konstatua se nuk ekzistojnë pengesa ligjore (përshkak se bëhet fjalë për periudhë zgjedhore) për realizimin e procedurës e transferit të një personi nga institucion tjetër publik, anëtarët japin pëlqimin që të realizohet ajo procedurë. Pëlqimi është nënshkruar nga kryetari i Komisionit të AKE, Gordana Klinçarska me numër 1102-8/4 për punësimin pa shpallje publike nëpërmjet transferit të përhershëm të një realizatori për një kohë të pa caktuar në vendin e punës Këshilltarë i Drejtorit për resurse njerëzore dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Në ditën e njëjtë MSHIA (Ministria për shoqëri informatike dhe administratë) jep përqim me numër 12-/5-1604/2 për transferin e përhershëm të Sanja Dimitrievska nga Zyra e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në AKE.

Drejtori i AKE me datë 30.05.2017 jep Deklaratë me numër 0201-1653/6 se transferi i personit Sanja Dimitrievska nga Zyra e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në AKE është urgjent dhe që nuk mund të shtyhet, veçanërisht përshkak të efikasitetit dhe efektivitetit për realizimin e detyrave të punës, si dhe për shkak të rritjes së punës në vendin e theksuar të punës i cili është i paraparë në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në AKE. Po në atë ditë, personi Sanja Dimitrievska jep Deklaratë se është pajtuar që ta bëjë transferin e dakorduar.

Marrëveshja e dakorduar për punësim pa shpallje publike nëpërmjet transferit të përhershëm është nënshkruar ndërmjet AKE dhe Qeverisë së RM me datë 30.05.2017. Marrëdhënjet e punës së personit Sanja Dimitrievska i mbaron në VRM me datë 31.05.2017, kurse në AKE fillon me punë me datë 01.06.2017. Gjithashtu është firmosur Marrëveshje për punësim në AKE në vendin e punës Këshilltarë i drejtorit për resurse njerëzore dhe bashkëpunim ndërkombëtar me datë 30.05.2017 ndërmjet Sanja Dimitrievska dhe AKE.

Inspektorati administrativ shtetëror ka kryer inspektim të jashtzakonshëm në AKE me datë 19.10.2017, pas të cilin është përpunuar procesverbal IL1 numër 09-80. Në procesverbalin e theksuar është konstatuar se AKE nuk ka bërë Plan vjetor për punësime për vitin 2017 dhe 2018 në përputhje me nenin 20, 20-a dhe 20-b nga Ligji për punësime në sektorin publik dhe se është bërë plotësim i vendit të punës nëpërmjet procedurës për zhvendosje, gjegjësisht transferit të zyrtarit administrativ Sanja Dimitrievska në vitin 2017, me nënshkrimin e Marrëveshjes në periudhën para se të përfundon procesi zgjedhor për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në RM, mirëpo përshkak të urgjencës dhe që nuk mund të shtyhet, me çka nga ana e inspektorit administrativ është konstatuar se do të ndërmerrë masa të mëtutjeshme në përputhje me kompetencat e veta të rregulluara me ligj. Për pjesën tjetër të veprimit të AKE për këtë lëndë, inspektorit administrativ ka theksuar se lënda do të lëshohet në përgjegjësi të Inspektoratit shtetëror për punë (ISHP).

KSHPK u drejtua deri tek Inspektorati shtetëror administrativ në lidhje me inspektimin e theksuar të jashtzakonshëm në AKE nga ana e tyre dhe se vallë a janë marrë masa të mëtutjeshme në përputhje me kompetencat e tyre, siç është konstatuar nga ana e inspektorit administrativ. Nga ana e ISHA, KSHPK ishte informuar se për lëndën konkrete nuk janë ndërmarrë asnjë lloj masash dhe veprimesh në përputhje me kompetencat e këtij organi, me vërejtje se afati për vazhdimin e procedurës të caktuar me Ligjin për kundërvajtje edhe më tej vazhdon.

KSHPK gjithashtu u drejtua edhe deri tek Inspektorati shtetëror i punës në lidhje me procesverbalin e theksuar nga ISHA, vallë, nga ana e tyre a është vepruar dhe se a është bërë inspektim në AKE në lidhje me punësimin e personit Sanja Dimitrievska. Inspektorati shtetëror për punë e informoi KSHPK se pas adresimit deri tek ISHA në lidhje me atë se vallë nga ana e tyre është dorëzuar procesverbal me numër 09-80 nga data 19.10.2017, ISHA i informoi se nuk mund të vërteton se procesverbali i theksuar është dorëzuar në ISHA.

KSHPK përsëriu u drejtua deri tek Inspektorati shtetëror administrativ në lidhje me realizimin e jashtëzakonshëm të inspektimit në AKE dhe kërkoi që inspektori administrativ i cili e realizoi vëzhgimin të ndërmerr masa të metutjeshme në përputhje me kompetencat e veta. ISHA lajmëroi që në pikëpamje të Planit vjetor për punësime, cili për herë të parë u zbatua nga viti 2016 në Ligjin për punësime në sektorin publik, kurse inspektimet e jashtëzakonshme në më tepër institucione janë realizuar në vitin 2017 kurse personat udhëheqës ishin zënë dhe ngatërruar në procedurën për bërjen e të njëjtës, dhe përshkak se bëhet fjalë për dukuri masovike, dhe ishin të nevojshme dënime për shumicën, vendosën se do të ishte e pahijshme dhe u morr hapë në ISHA se inspektimet e jashtëzakonshme do të kenë vetëm karakter të vërejtjes dhe asnjë inspektor nuk ndërmorri veprimet të karakterit për dënim.

KSHPK përsëri u drejtua deri tek Inspektorati shtetëror i punës me qëllim që të vepron në përputhje me kompetencat e veta për procesverbalin me numër 09-80 nga data 19.10.2017 i përpunuar nga ISHA, pas të cilit KSHPK ishte informuar se në përputhje me procesverbalin e cituar dhe inspektorit që realizoi inspektimin e jashtëzakonshëm, procedura e punësimit të personit Sanja Dimitrievska është realizuar në përputhje me Ligjin. Sipas tyre, personi i njëjtë ka status të zyrtarit administrative, në përputhje me nenin 45 paragrafi 2 nga ligji për punësimin në sektorin publik, dhe sipas atij vëzhgimi të rregullativës të këtij ligji bënë Inspektorati shtetëror administrative.

Në përputhje me nenin 26 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, përshkak të qartësimit të qështjeve të caktuara në lidhje me marrjen e vendimit për kompetencat e veta, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) me datë 03.11.2020, në hapsirat e KSHPK, pati bisedë me Gordana Klinçarovska, anëtarë e komisionit të AKE.

Në takimin prezantoi kryetari i KSHPK, Biljana Ivanovska, anëtari i KSHPK m-r Vlladimir Georgiev dhe zyrtari administrative Kate Zdravkoska.

Anëtari i KSHPK, m-r Vlladimir Geogiev i cili është i ngarkuar me çështjen e lëndës me numër 09-1105/1 nga data 07.03.2017 e njoftoi Gordana Klinçarovskën me akuzat e lëndës së njëjtë dhe me veprimet e KSHPK në lidhje me të dhënat e fituara nga ana e AKE.

Gjegjësisht, nga ana e KSHPK ishte konstatuar se anëtari i AKE, Gordana Klinçarovska (ish-kryetare e atij komisionit, në periudhën kur është punësuar personi Sanja Dimitriovska), me datë 23.05.2017 nënshkroi akt me të cilin bëhet ndryshimi në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në AKE, edhe pse ato ndryshime të rregullores vetë Komisioni i AKE i miratoi në mbledhjen e mbajtur me datë 25.05.2017, e parë nga procesverbali i marrur nga mbledhja e shtatë e komisionit të AKE. Me ndryshimet e Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në AKE për vendin e punës "Këshilltarë i drejtorit për resurse njerzore dhe bashkëpunim ndërkombëtar" në pjesën e arsimimit, fjala "shkenca ekonomike" zëvendësohet me fjalën "makineri", edhe pikërisht ajo është përgaditja profesionale e të punësuarës Sanja Dimitriovska.

Gordana Klingarovska, anëtare e Komisionit të AKE sqaroi se bëhet fjalë për gabim teknik/i shtypur nga akti i përmendur me të cilin bëhet ndryshim në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në AKE dhe se data duhet të bëhet 25.05.2017, sepse vendimet e Komisionit të AKE i marrin vetëm në mbledhjet e realizuara.

Në senacën e mbajtur me datë 11.11.2020, pas rishikimit të të gjitha akuzave për lëndën dhe dokumentacionit plotësues të dorëzuar dhe informacioneve, KSHPK vërtetoi se është bërë ndryshim në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në AKE, për vendin e punës në të cilën është punësuar Sanja Dimitrievska, ku në vend të "shkenca ekonomike" janë zëvendësuar me "makineri", arsimim të cilën e posedon e emëruara. Procedura e plotë për marrjen e këtij personi zyrtar është realizuar në periudhë të shkurtë kohore, për kohën ende të pambaruar të periudhës zgjedhore. Duke parë se inspektorët shtetëror kompetent nuk vërtetuan thyerje të rregullativave ligjore gjatë procedurës së transferit, në rastin konkret KSHPK nuk ka bazë ligjore për ndërmarrjen e masave të mëtutjeshme dhe aktiviteteve në përputhje me Ligjin për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Në bazë të të theksuarës më lartë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi në bazë dispozitave të këtij vendimi.

Pas përfundimit të KSHPK
Punoi: Këshilltarë K. Z.
Miratoi: M-r V. G., anëtarë i KSHPK

**КОМИСИОНИ СШТЕТЌОРОР ПЉР
ПАРАНДАЛИМ ТЉ
КОРРУПСИОНИТ
Крыетарë: Biljana Ivanovska**